



UDHEZUES

PER SIGURINE GJATE PERDORIMIT TE INTERNETIT

1. Si te mbroni kompjuterin tuaj

Lexoni me kujdes politikat e privatesise per faqet e Internetit te cilat i perdorni. Mbajini te gjitha programet kompjuterike (duke perfshire edhe browser-in tuaj) ne perditesim automatik. Keshillohet te mos ruhen ne browser username dhe password te adresave tuaja email apo kredenciale logimi ne sisteme te ndryshme. Perdorni programe kompjuterike si firewall, antivirus, antispam, antispysware, apo software te tjera per mbrojtjen e lundrimit tuaj ne rrjet. Programe te tilla me License nga prodhuesit garantojne mbrojtje shume te mire te pajisjeve tuaja qe perdorin internetin. Vendosni fjalekalime me karaktere dhe shkronja te vecanta per te mbrojtur lidhjen tuaj wireless ne shtepi. Instaloni update (perditesimet) e sistemit operativ Windows te quajtur 'Windows Update' i cili eshte nje sherbim qe ofron Microsoft dhe kjo e lejon kompjuterin tuaj te qendroje i perditesuar dhe larg kercenimeve te sigurise si viruse apo malware dhe komponenteve te tjera te demshme.

Vizitoni faqen www.microsoft.com per te perditesuar sistemin operativ te kompjuterit tuaj. Microsoft njofton shpesh ne kompjuterin tuaj per software updates (rifreskime te programeve) qe jane projektuar per te zgjidhur kercenimet e sigurise dhe sugjerojme ti pranoni keto perditesime.

Perdorues te sistemeve te tjera operative si Linux, Android, IOS, etj, duhet te vizitojne faqet e prodhuesve dhe zhvilluesve te keteyre sistemeve operative.

2. Mbroni te dhenat tuaja personale

Perpara se te vendosni te dhenat tuaja, shikoni per shenja te sigurise qe nje Web faqe mund te kete; Web https ("s", e siguruar) dhe nje çeles te mbyllur afer. Asnjehere mos jepni te dhenat tuaja ne pergjigje te nje e-maili, etj. Publikoni sa me pak detaje qe iu identifikojne juve apo vendndodhjen tuaj. Kujdes! Mos publikoni online gjera per te cilat nuk deshironi te jene publike Informacion me te detajuar per mbrojtjen e te dhenave personale d te gjeni me poshte.

3. Mendoni perpara se te publikoni

Mendoni perpara se te bashkengjitni skedare a foto, apo te klikoni mbi nje link ne nje e-mail; ne qofte se ju nuk i njihni derguesit, ata mund te jene te rreme. Jini te kujdesshem kur klikoni link-e te ndryshme ne internet. Mos ndani me njerez te panjohur e-mail adresen tuaj private dhe mbajeni per vete fjalekalimin. Gjate plotesimit te formulareve te ndryshem plotesoni vetem fushat e kerkuara (ato te shenuara me yll *. Vertetoni se faqja e Internetit eshte e sigurt duke kerkuar shenja identifikuese; Mos publikoni identitetin tuaj kur luani lojera online, por perdorni nofka per veten tuaj (pseudonime);

4. Krijoni fjalekalim te forte dhe mbajeni ate te fshehte

Krijoni fjalekalim me te pakten tete karaktere (sa me i gjate, aq me i mire) dhe perfshini ne te germa te medha dhe te vogla, numra dhe simbole. Mos perdorni te njejtin fjalekalim kudo.

5. Mbroni veten nga mashtrimet nga e-maile te panjohura

Perpara se ti lexoni, shikoni me kujdes emertimet/titujt e emaileve qe merrni, sidomos ato me tituj "fitues", mesazhet me shenime si "gabim", mesazhe me gabime gramatikore, mesazhet me kerkesa per te dhenat tuaja personale, si numra llogarie, karte krediti, etj. Mendoni se jo gjithmone ajo qe duket shume e mire, eshte e tille.

6. Perdorimi i sigurt i rrjeteve sociale

Per t'u regjistruar dhe perdoru disa rrjete sociale, si psh "Facebook", "Tweeter", "Instagram", etj, zakonisht kerkohet qe mosha e personit te jete mbi 13 vjeç. Shikoni per mundesine "Rregullo privatesine" ne rrjetet sociale, per te menaxhuar se cilet persona mund te shohin profilin tuaj. Kontrolloni se si njerezit mund t'ju kerkojne ne rrjet dhe te bejne komente. Gjithashtu, mesoni se si mund te bllokoni hyrjet e padeshiruara. Mos postoni çdo gje qe ju mendoni. Perzgjidhni me kujdes pranimin e miqve te rinj, si dhe rishikoni periodikisht se çfare miqte publikojne ne lidhje me ju.

MBROJTJA E TE DHENAVE PERSONALE DHE PRIVATESISE GJATE PERDORIMIT TE INTERNETIT:

Zhvillimi i teknologjise se informacionit dhe te sistemeve elektronike ka sjelle rritjen e rendesise se te dhenave personale te pajtimtareve dhe kompania jone permbush te gjitha detyrimet per mbrojtjen e te dhenave personale qe rrjedhin nga kuadri ligjor dhe nenligjor ne fuqi.

PERKUFIZIME

“Te dhena personale” është çdo informacion në lidhje me një person, të identifikuar ose të identifikueshem, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a me shumë faktoreve të veçante për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

“Perpunimi i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, pershtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

"Te dhena sensitive" është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, denimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

“Te dhëna për trafikun e komunikimeve” është çdo e dhënë e përpunuar për qëllime të transmetimit të komunikimeve në një rrjet të komunikimeve elektronike ose për qëllime faturimi.

LLOJI I TË DHËNAVE PERSONALE

Kompania jone do të marrë nga pajtimtaret e tij të dhënat e parashikuara në nenin 129 të Ligjit nr. 9918 të datës 19.05.2008 “*Per Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, emër, mbiemër, adresë, numri unik i identifikimit të subjektit (nese ka), numri fiks i telefonit, numrin e aksesit, adresa e postës elektronike si dhe çfaredolloj të dhënash të tjeter kontakti.

Kompania jone nuk përpunon të dhëna sensitive të përcaktuara në bazë të nenit 3 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Per Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar.

PERPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Mbrojtja e të dhënave personale garantohej me përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme të këtyre të dhënave nga kompania jone për përbushjen e detyrimeve kontraktuale apo ligjore të kompania jone që rrjedhin prej Kontrates së Pajtimin nenshkruar mes paleve, si dhe rritjen e cilësive të shërbimeve ndaj pajtimtareve.

Kompania jone do të veprojë vetëm në përputhje me parimet ligjore për përpunimin e të dhënave personale, siç janë parashikuar në Ligjet nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Per Mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar dhe nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Per Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, si dhe kuadrin rregullator përkatës në fuqi.

Aksesi dhe kërkesa për korrigjim dhe fshirje :

Pajtimtari ka të drejtë të kërkojë me shkrim dhe pa pagesë që të marrë nga kompania jone:

- konfirmimin nëse të dhënat personale po i perpunohen ose jo, informacion për qëllimin e perpunimit, për kategoritë e të dhënave të perpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;
- në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre;
- në rastet e vendimeve automatike, informacion për logjikën e përfshirë në vendimmarrje.

Kompania jone brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, do të informojë pajtimtarin mbi kërkesën e tij dhe informacionin për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishin në kohën kur është bërë kërkesa. Në rast se nuk i jepet informacioni, kompania jone duhet t'i shpjegojë pajtimtarit arsyet e mosdhënies së informacionit.

Pajtimtari ka të drejtë të kërkojë me shkrim dhe pa pagesë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave kur konstatohet se të dhënat e tij nuk janë të rregullta, të verteta, të plota, ose janë perpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Kompania jone, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, do të informojë Pajtimtarin për perpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit ose fshirjes të të dhënave.

Pelqimi i pajtimtarit:

Perveç kur perpunimi i të dhënave kryhet në përmbushje të kriterëve ligjorë të parashikuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, pelqimi i Pajtimtarit do të merret përpara se të dhënat e tij të perpunohen. Ky pelqim do të jetë në mënyrë të shprehur dhe sipas vullnetit të plote dhe të lirë të Pajtimtarit.

Pajtimtari ka të drejtë të mos të jetë pjesë dhe të kundërshtojë në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, perpunimin e të dhënave personale të tij për qëllime të tregtimit të drejtëpërdrejtë.

Kompania jone do të marrë pelqimin paraprak me shkrim të Pajtimtarit të cilit mund të jetë e nevojshme t'i perpunohen të dhënat personale për qëllimin e mesipër. Pajtimtari ka të drejtë të terheqë pelqimin e tij për sa me siper.

Në rastin kur të dhënat personale do t'u përhapen paleve të treta konform kërkesave të ligjit 9887, kompania jone merr përsiper që Pajtimtari të jetë i

informuar per:

- a) marresit e te dhenave dhe qellimin per te cilin perhapen;
- b) te drejtat e Pajtimtarit te lartpermendura.

Perhapja e te dhenave personale tek te tretet:

Perhapja e te dhenave personale tek te tretet do te behet vetem ne perputhje me kuadrin ligjor dhe nenligjor ne fuqi per perpunimin e te dhenave personale, si dhe ne permbushje te detyrimeve kontraktuale te kompanise tone. Palet e treta jane te detyruar ligjerisht te ruajne konfidencialitetin dhe besuesshmerine e te dhenave personale te pajtimtareve.

Kompania jone eshte i detyruar ligjerisht te beje te ditura te dhenat personale bazuar ne kerkesat e posaçme te organeve shteterore, perfshire ato te pushtetit gjyqesor dhe te ndjekjes penale, ne perputhje me dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Kompania jone do te ruaje dhe te administroje, per nje afat 2-vjeçar, skedaret e te dhenave te pajtimtareve. Te dhenat ne keta skedare ruhen sipas legjislacionit ne fuqi per mbrojtjen e te dhenave personale. Keta skedare duhet t'u vihen ne dispozicion pa vonese, edhe ne forme elektronike, autoriteteve qe percakton Kodi i Procedures Penale, ne baze te kerkeses se tyre.

Pergjimi i ligjshem i komunikimeve elektronike behet vetem nga autoritetet e ngarkuara me ligj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, perkatesisht Nenin 131 te Ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise, i ndryshuar dhe Ligjin nr.9157, date 04.12.2003 "Per pergjimin e komunikimeve elektronike".

Kompania jone me anen e Serverave dhe Programeve te saj, me teknologji bashkekohore mbron dhe siguron fizikisht dhe elektronikisht fshehtesine dhe konfidencialitetin e te dhenave personale te pajtimtareve, si dhe merr cdo mase te nevojshme teknike per te ndaluar aksesin apo hyrjen ne sistemet e komunikimeve elektronike dhe te perpunimit te te dhenave personale nga persona te paautorizuar. Ne çdo rast, kompania jone do te informoje menjehere, Komisionerin per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjes se te Dhenave Personale, ne rast se dyshon apo njoftohet se eshte rrezikuar siguria e te dhenave personale te pajtimtareve.

Kompania jone mund te mbledhe, perpunoje dhe perdore te dhenat mbi pajtimtaret kur te dhena te tilla jane direkt te percaktuara per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike dhe/ose per te mbajtur nje funksionim normal te rrjetit dhe pajisjeve dhe zbulimin dhe ndjekjen sulmeve kibernetike apo fizike ndaj rrjetit te kompanise tone, sipas kerkesave te Kreut XI dhe ne vijim te ligjit nr. 9918 date 19.5.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar.